

Hajrije Devetaku
Selim Mehmeti
Haxhere Zylfiu

1. BRAKTISJA E SHKOLLIMIT NGA NXËNËSIT NË KOSOVË

Përmbledhje ekzekutive

Procesi i reformës në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë ka filluar nga vitit 2001, duke përfshirë strukturën e nivelit të shkollimit, legjislacionin arsimor, kornizën e kurrikulit, planet dhe programet mësimore, tekstet shkollore, zhvillimin profesional të mësimeve, etj. Me gjithë ndryshimet e filluara, sistemi i arsimit parauniversitar në Kosovë vazhdon të ballafaqohet me sfida të ndryshme. Hulumtimi i braktisjes është nevojë dhe domosdoshmëri, meqenëse braktisja e shkollës nga nxënësit është një nga sfidat më të mëdha dhe më të ndjeshme të arsimit parauniversitar në Kosovë. Iniciativa për këtë hulumtim është marrë gjatë punëtorisë së organizuar për hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës: *Menaxhimi i nxënësve në mësim dhe parandalimi i braktisjes*. Hulumtimi është realizuar në Prishtinë gjatë muajve korrik-shtator të vitit 2009.

Çështja e braktisjes së shkollës është një kaptinë e veçantë që meriton studim kompleks të saj. Hulumtimi: *Braktisja e shkollimit nga nxënësit në Kosovë* është fokusuar në disa nga çështjet që lidhen ngushtë me dukurinë e braktisjes, si: shkaqet e braktisjes së shkollës nga nxënësit, pasojat nga braktisja e shkollës, niveli i shkollimit dhe mosha e nxënësve që braktisin shkollën, masat për kthimin e nxënësve në shkollë që paraprakisht kanë braktisur shkollën, përgjegjësit dhe masat për parandalimin dhe luftimin e braktisjes.

Ekipi hulumtues, në bashkëpunim me profesor Glyn Kirkham, përcaktoi fushën e hulumtimit dhe hartoi metodologjinë e punës përmes qasjes së vlerësimit dhe reagimit të shpejtë. Hulumtimi kishte për qëllim që të sillte të dhëna dhe mendime për braktisjen e shkollës nga nxënësit në Kosovë përmes analizës së gjendjes ekzistuese dhe pasqyrimin të pikëpamjeve të qytetarëve të intervistuar për braktisjen. Teknikat dhe instrumentet për mbledhjen e të dhënave përfshijnë intervistat dhe pyetësorët me grupet e interesit, si dhe diskutimet me zyrtarë arsimor dhe specialistë të arsimit në Kosovë. Janë realizuar intervista me 99 qytetarë të rastit të komuniteteve, moshave, profesioneve dhe vendbanimeve të ndryshme të Kosovës dhe diskutime zyrtarë dhe specialistë të arsimit. Klasifikimet e të intervistuarve janë bërë sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike dhe shkallës së kualifikimit.

Gjetjet kryesore, përfundimet dhe rekomandimet janë përmbledhur në raportin e gjerë të hulumtimit. Rezultatet tregojnë se sistemi i arsimit në Kosovë vazhdon të ballafaqohet me problematikën e braktisjes së shkollës nga nxënësit, në veçanti në zonat rurale dhe nga komuniteti rom, ashkali e egjiptian. Kjo, sipas hulumtimeve paraprake, analizës së gjendjes, mendimit të respondentëve të përfshirë në hulumtim, ndodh për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në vend, mungesës së perspektivës për punësim të rinjve, mbështetjes së pamjaftueshme të fëmijës/nxënësit nga familja, numrit të madh të nxënësve në klasë, cilësisë jo të mirë të mësimdhënies, mungesës së bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet në funksion të trajtimit të drejtë të dukurisë së braktisjes, mungesës së programeve mbështetëse për nxënësit me vështirësi në mësimnxënie, mungesës së transportit të qëndrueshëm për nxënësit, kushtet jo të mira në shkolla, etj.

Ndarja e qartë e roleve, detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve në nivel qendror dhe lokal, hartimi i strategjisë për parandalimin e braktisjes dhe kthimit të nxënësve në shkollë që paraprakisht kanë

braktisur shkollimin, ofrimi i programeve mbështetëse që adresojnë në mënyrë të drejtë dhe të plotë braktisjen, krijimi i perspektivës për punësimin e të rinjve, sigurimi i transportit të qëndrueshëm për nxënës, përmirësimi i kushteve të punës në shkolla, bashkëpunimi aktiv shkollë-familje-komunitet, etj., do të ndikojnë në parandalimin e braktisjes dhe kthimin në shkollë të nxënësve që kanë braktisur shkollën. Ngritja e shkallës së përgjegjësisë, nga familja deri tek institucionet më të larta shtetërore, do të ndikojë në parandalimin e braktisjes së shkollimit dhe kthimit në shkollë të atyre që kanë braktisur shkollimin.

Executive summary

The process of pre-university reform in Kosova began in 2001, including the structure of education system, education legislation, curriculum framework, education plans and programs, school texts, professional development of teachers, etc. With all these initiated changes, the system of pre-university education in Kosova continues to be faced with a variety of challenges. The abandonment¹ of school by pupils is one of the biggest and most sensitive challenges for the pre-university education in Kosova, and the research of abandonment is both a need and a necessity. The initiative for such research was taken during a workshop organized on research at the Kosova Pedagogical Institute: The management of pupils and prevention of abandonment. The research was realized in Prishtina during July-September period 2009.

The research: *Abandonment of schools by pupils in Kosova* is focused on several of the issues that are closely linked to the phenomenon of

¹ In this paper, we use the term “abandonment” to mean, consistent and persistent non-attendance at school by children and young people of compulsory school age and not occasional days of absence or causal truancy.

abandonment of schools, such as: causes of abandonment of schools by pupils, consequences deriving from abandonment of schools, level of education and age of pupils abandoning school, measures for return of pupils who had previously abandoned school back to schools, responsible ones and prevention and combating measures against abandonment.

The research team (in cooperation with facilitator, Glynn Kirkham) determined the area of research and drafted the methodology of work through approach of assessment and fast reaction. The research aimed to bring data about the abandonment of schools by pupils in Kosova through an analysis of the existing situation and through reflection of opinions of citizens interviewed regarding the abandonment. The techniques and instruments for the collection of data include interviews and questionnaires with groups of interest and also discussions with education officials and specialists of education in Kosova. 99 citizens of different communities, ages, professions and different locations in Kosova were interviewed, and 10 discussions with officials and specialists of education were conducted. Classifications of the interviewed are according to age, gender, ethnic background and level of qualification.

The main findings, conclusions and recommendations are summarized in the detailed research report.

Hyrje

Iniciativa për këtë hulumtim është marrë gjatë punëtorisë së organizuar në korrik 2009 nga CESES-i për hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës me temën: *Menaxhimi i nxënësve në mësim dhe parandalimi i braktisjes*. Hulumtimi është mbështetur nga Prof. Glyn Kirkham. Hulumtimi është realizuar në Prishtinë dhe Gjakovë gjatë muajve korrik-shtator të vitit 2009.

Për të arritur tek gjetjet kryesore të hulumtimit, bazuar në pikësynimet e hulumtimit, kemi mbledhur të dhënat përmes shqyrtimit të dokumentacionit që e trajton braktisjen, analizës së hulumtimeve të deritashme për braktisjen, në veçanti përmes përpunimit të informacionit të marrë nëpërmjet intervistës së qytetarëve të përfshirë në hulumtim. Të dhënat e fituara i kemi përpunuar, analizuar dhe interpretuar. Besojmë se rezultatet nga ky hulumtim, përfundimet dhe rekomandimet që do të ofrojmë, do të jenë në ndihmë të atyre që drejtpërdrejtë merren me trajtimin e braktisjes.

Konteksti i përgjithshëm i arsimit parauniversitar në Kosovë

Sistemi i arsimit në Kosovë në vitet 1990- 1999 ka bërë luftë për mbijetesë për shkak të përjashtimit dhe ndarjes nga pushteti serb i vendosur me dhunë në Kosovë. Drejtuesit e arsimit dhe mësimdhënësit në partneritet të ngushtë me prindër, nxënës dhe pjesëtar të shoqërisë, kanë arritur që arsimin në Kosovë ta vetëfinancojnë, ta organizojnë mësimin në forma të ndryshme – edhe në shtëpi shkollë², vetëm e vetëm që fëmijët në Kosovë të mos mbesin pa u

² Mësimi në shtëpi-shkollë është organizuar në të gjitha lokalitetet në të cilat kanë qenë shkollat duke punuar, por të cilat janë larguar nga forcat serbe të instaluar në Kosovë.

përfshirë në rrugën e dijës, në rrugën e së ardhmes. Rruga e sistemit arsimor në Kosovë në këto vite ka qenë mjaft e vështirë, me plot sakrifica dhe dhembje, me paga simbolike të mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave (apo edhe pa paga fare), megjithëkëtë sistemi arsimor në Kosovë arriti të mbijetojë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në qershor të vitit 1999, filloi riorganizimi i sistemit arsimor. Në vitet e para të pas luftës vëmendje e veçantë i është kushtuar ndërtimit të shkollave të rrënuara gjatë luftës, pajisjes së shkollave me inventar dhe mjete të nevojshme për zhvillim të procesit mësimor.

Nga viti 2000, në Kosovë ka filluar procesi i reformës në sistemin e arsimit, duke përfshirë strukturën arsimore³, legjislacionin arsimor, kornizën e kurrikulit, planet dhe programet mësimore, tekstet shkollore, zhvillimin profesional të mësimdhënësve etj. Me gjithë ndryshimet e filluara, sistemi arsimor në Kosovë vazhdon të ballafaqohet me sfida të ndryshme. Pa dyshim, braktisja e shkollës nga nxënësit është një nga sfidat më të mëdha dhe më të ndjeshme për arsimin parauniversitar në Kosovë.

Lëvizja e brendshme e nxënësve të Kosovës dhe jashtë vendit ka ekzistuar dhe ende vazhdon të ekzistojë. Lëvizje gjatë viteve të fundit janë regjistruar më shumë nga zhvendosja e popullsisë në zona urbane, gjë që ka ngarkuar tej mase shkollat urbane të cilat janë detyruar të punojnë në tri e më shumë ndërrime brenda ditës dhe si pasojë shkurtimi i orëve të mësimi. Kjo ka ndikuar që hapësira kohore për komunikim mes nxënësve lidhur me çështjet e shkollës dhe arsimin në përgjithësi të jetë më e vogël. Lëvizja e madhe e nxënësve ka bërë që procesi i menaxhimit të dhënave të lëvizjes së nxënësve të jetë në krizë.

³ Struktura e re (5+4+3) do të zëvendësonte strukturën e vjetër (4+4+4). Kjo strukturë nënkuptonte zgjatjen e arsimit të detyrueshëm për një vit më shumë. Struktura e re 5+4+3/4, nënkuptonte 5 vite shkollë fillore, 4 vite shkollë e mesme e ulët dhe 3 përkatësisht 4 vite shkollë e mesme e lartë. Vendimi për ndryshimin e strukturës nga tetë në nëntë vite u mor në gusht të vitit 2000. Harmonizimi i strukturës arsimore me strukturat e vendeve të përparuara evropiane e botërore, ishte arsyeja kryesore e ndërrimit të strukturës arsimore në Kosovë.

Gjendja ekonomike dhe varfëria janë ndër faktorët më me ndikim sa i përket shkaqeve të rritjes së numrit të nxënësve që braktisin shkollën. Rezultatet nga hulumtimi për braktisjen e shkollës si dhe të dhënat statistikore të MASHT-it⁴ tregojnë se Kosova po ballafaqohet me probleme të mëdha sa i përket përfshirjes së nxënësve në shkollë.

Çështjet që lidhen me trajtimin e braktisjes nga institucionet e arsimit në Kosovë do të trajtohen në kapitullin e tretë: *Vlerësimi për gjendjen aktuale të trajtimit të braktisjes.*

Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi për braktisjen e shkollës është projektuar për të zbatuar metodologjinë e punës përmes qasjes së vlerësimit dhe reagimit të shpejtë duke u bazuar në shqyrtimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese dhe në intervistimin e qytetarëve të rastit.

Objekti, qëllimi dhe objektivat e hulumtimit

Objekti i hulumtimit. Studimi i dukurisë së braktisjes është një çështje mjaft komplekse e cila kërkon analizë të gjendjes dhe të faktorëve ndikues. Objekt i hulumtimit është *braktisja e shkollës nga këndvështrimi i analizës së gjendjes dhe pikëpamjeve të qytetarëve*. Në fokus të hulumtimit do të jenë:

- Shkaqet e braktisjes së shkollës nga ana e nxënësve
- Pasojat nga braktisja e shkollës
- Niveli i shkollimit dhe moshë e nxënësve që braktisin shkollën
- Masat për kthimin e nxënësve në shkollë që paraprakisht kanë braktisur shkollën

⁴ SMIA çdo vit shkollor harton raportin statistikor : Statistikat e arsimit në Kosovë. Në këtë raport pasqyrohen edhe të dhënat për përfshirjen e nxënësve në shkollë.

- Përgjegjësit dhe masat për parandalimin dhe luftimin e braktisjes

Qëllimi i hulumtimit. Qëllimi i hulumtimit i përgjigjet objektit të hulumtimit dhe është i orientuar në përcaktimin e masave të ndryshme të cilat do të prezantohen përmes nxjerrjes së rekomandimeve për të gjithë faktorët e bashkëpunimit në shkollë për adresojuar drejtë problemin e parandalimit dhe luftimit të braktisjes së shkollës.

Objektivat e hulumtimit. Qëllimin e hulumtimit kemi synuar ta realizojmë përmes këtyre objektivave:

- Shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit e studimeve që adresojnë braktisjen e shkollës nga nxënësit në Kosovë
- Mbledhja e të dhënave nga analizat statistikore të përfshirjes së nxënësve në shkollë
- Marrja e pikëpamjeve të shtresave të ndryshme të qytetarëve për braktisjen e shkollës
- Analiza dhe interpretimi i të dhënave të fituara nga hulumtimi dhe vendosja e tyre në një raport të hulumtimit.
- Propozimi i masave për adresimin e problemit të braktisjes në shkollë, bazuar në përfundimet e hulumtimit.

Popullatat dhe mostra

Braktisja e shkollës është brengë dhe shqetësim i gjithë qytetarëve. Parandalimi i dukurisë së braktisjes do të jetë në interes të të gjithë qytetarëve, prandaj qytetarë të rastit, të komuniteteve, moshave, profesioneve dhe vendbanimeve të ndryshme të Kosovës kanë qenë popullatat nga të cilat ekipi hulumtues ka përzgjedhur mostrën për përfshirje në hulumtim. Nga popullatat e përcaktuara për mostër, janë intervistuar 99 qytetarë të rastit, të komuniteteve, moshave e profesioneve të ndryshme.

Metodat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit

Për të arritur qëllimin dhe objektivat e hulumtimit kemi përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit, teknikën e intervistimit dhe instrumentin e pyetësorit me pyetje të hapura.

Metoda e analizës teorike. Përmes kësaj metode kemi analizuar politikat arsimore, planet dhe strategjitë që e trajtojnë braktisjen, hulumtimet mbi braktisjen e shkollës dhe programet mbështetëse për trajtimin e braktisjes.

Metoda krahasuese. Përmes kësaj metode janë krahasuar rezultatet e treguesve statistikor që e pasqyrojnë braktisjen në vitet e fundit, janë krahasuar dallimet në përgjigjeje të fituara nga respondentët e përfshirë në hulumtim.

Metoda statistikore. Përmes kësaj metode janë paraqitur statistikisht rezultatet nga intervistimi i respondentëve të përfshirë në hulumtim. Po ashtu, me ndihmën e kësaj metode, kemi nxjerrë tregues të ndryshëm në hulumtim, si dhe kemi bërë paraqitjen e të dhënave të hulumtimit në mënyrë tabelare dhe grafike.

Teknika e intervistës. Teknikën e intervistës e kemi përdorur me qëllim të mbledhjes së të dhënave për disa nga çështjet kryesore të braktisjes së shkollimit, si: shkaqet dhe pasojat nga braktisja e shkollës, niveli i shkollimit dhe mosha e nxënësve që braktisin shkollën, masat për kthimin e nxënësve në shkollë që paraprakisht kanë braktisur shkollën, përgjegjësit dhe masat për parandalimin dhe luftimin e braktisjes.

Pyetësorët. Nga ekipi hulumtuesit u përgatitën lloje të ndryshme të pyetjeve me përmbajtje të ndryshme, të cilat pastaj u diskutuan dhe në pyetësor u vendosen pyetjet të cilat mund të nxjerrin informata të nevojshme për fushën e hulumtimit. Pyetjet që u përfshin në pyetësorin e intervistës ishin:

1. Çfarë kuptoni me braktisje të shkollës?
2. Cila është shkalla e braktisjes së shkollës në Kosovë?

3. Në cilin nivel të arsimit është më e shprehur më shumë braktisja e shkollës?
4. Cilat janë shkaqet e braktisjes së shkollës nga nxënësit?
5. Sa është ndikues në braktisjen e shkollës migrimi fshat-qytet ?
6. Çfarë nuk ju pëlqen fëmijëve në shkollë dhe që shkakton braktisjen e shkollës?
7. Cilat janë pasojat e nga braktisja e shkollës?
8. Kush duhet të merret me këtë problem?
9. Çfarë duhet të bëjnë prindërit, shkolla dhe institucionet për të parandaluar braktisjen e shkollës?
10. Si mund ta ndihmojmë familjen që fëmijët të mos e braktisin mësimin?
11. Çka duhet ndërmarrë që nxënësit të cilët kanë braktisur shkollën të vazhdojnë shkollimin?
12. A duhet të ndërmerren masa ligjore ndaj prindërve të fëmijëve që e braktisin shkollën? Çfarë masash duhet marrë?

Karakteristikat kryesore të pjesëmarrësve të përfshirë në hulumtim

Gjatë hulumtimit në terren janë intervistuar 99 qytetarë, prej tyre 64 meshkuj dhe 35 femra, të moshave të ndryshme dhe të zonave të ndryshme urbane dhe rurale, të intervistuar në Prishtinë dhe Gjakovë. Prej tyre 93.65 % ishin shqiptarë dhe 6.35 nga komunitetet RAE. Figura nr. 1 pasqyron të dhënat e pjesëmarrësve të përfshirë në hulumtim sipas moshës dhe gjinisë.




Figura nr. 1

Të intervistuarit e përfshirë në hulumtim kanë nivele të ndryshme të arsimit. Mbi 10 % të të intervistuarve nuk e kanë arsimin fillor, 18 % arsimin fillor, 28 % arsimin e mesëm të lartë dhe mbi 43 % janë me arsim superior. Figura nr. 2 pasqyron të dhënat e pjesëmarrësve të përfshirë në hulumtim sipas nivelit të shkollimit.




Figura nr. 2

Ekipi hulumtues

Hulumtimi për braktisjen e shkollës ishte pjesë e zhvillimit të punëtorisë: Menaxhimi i nxënësve në mësim dhe parandalimi i braktisjes, kjo nënkupton se në hulumtim janë përfshirë të gjithë hulumtuesit e IPK-së, pjesëmarrës në punëtori. Struktura e hulumtuesve të përfshirë në hulumtim ishte e përbërë prej hulumtuesve të sektorit për: Hulumtim, Planifikim Mësimor, Arsim dhe Arsim permanent.

Ekipin hulumtues e përbënte edhe Prof. Glyn Kirkham - Këshilltar Akademik, i cili ishte përfshirë në të gjitha fazat e hulumtimit, në hartimin e metodologjisë hulumtuese, analizën e të dhënave si dhe në hartimin e raportit përfundimtar.

Organizimi i punës në terren

Mënyra e organizimit të punës është përcaktuar në bashkëpunim me profesor Glyni Kirkham. Ekipet hulumtuese janë ndarë në 4 grupe, secili grup ka pas pyetjen e parë, për të kuptuar nëse të intervistuarit (respondentet) e kanë të qartë temën dhe pyetjen e fundit, nëse kishin për të shtuar diçka që nuk kishin thënë dhe pyetje tri të veçanta me të cilat trajtohej problematika. Grupit i është kërkuar që të intervistojë më së paku 25 respondentë. Grupi kishte koordinatorin e vet. Para zbatimit të intervistave, grupi diskutoi çështjet që lidhen me mënyrën e intervistimit dhe me etikën e sjelljes me respondentë. Me këtë rast u vendos që të gjithë të intervistuarit të informohen lidhur me hulumtimin dhe qëllimin e tij, si dhe të marrin pëlqimin e subjekteve për intervistim. Përzgjedhja e të intervistuarve u bë në mënyrë të rastësishme.

Gjatë punës në terren, ekipi hulumtues pati edhe probleme të ndryshme. Koha e kufizuar ishte një problem në vetë, po ashtu edhe intervistimi i kandidatëve vetëm në Prishtinë dhe Gjakovë ishte një

problem që nuk mund të siguronte pjesëmarrjen e respondentëve nga komunat tjera që ndoshta do të na siguronin të dhëna tjera për problemin e braktisjes. Në disa raste të intervistuarit hezitonin të përgjigjeshin në pyetje, sidomos të ata të moshës më të re.. Për shkak se çdo grup i hulumtuesve e kishte numrin e caktuar të personave që do të intervistoheshin, kishte vështirësi në gjetjen e grupmoshave të ndryshme që duhej t'i përshtateshin kriterëve të intervistimit.

Analiza dhe raportimi i të dhënave të hulumtimit

Analiza e të dhënave nga intervistat u krye nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës. Fillimisht të dhënat u përpunuan sipas grupeve dhe bazuar në to është përgatitur raporti fillestar. Publikimi i raportit fillestar është bërë në seancën vijuese të punëtorisë për Menaxhimin e nxënësve në mësim dhe parandalimi i braktisjes. Pas raportimit të grupeve, u formua grupi prej tre anëtarëve: Hajrije Devetaku, Selim Mehmeti dhe Haxhere Zylfiu të cilët u morën me integrimin e raporteve të grupeve nga hulumtimi në terren në një raport të vetëm, analizën e të dhënave statistikore të përfshirjes së nxënësve në nivelet e arsimit parauniversitar, analizën e dokumenteve në Kosovë që e trajtojnë braktisjen dhe me përgatitjen e raportit të hulumtimit për publikim të veçantë.

Vlerësimi për gjendjen e tanishme të trajtimit të braktisjes në Kosovë

Njohja me politikat, udhëzimet, planet e veprimit, strategjitë që janë në zbatim apo që janë në fazën përgatitore, është e një rëndësie të veçantë, prandaj grupi për përgatitjen e raportit integral të hulumtimit ka bërë angazhim në vlerësimin e gjendjes së tanishme. Informatat

janë siguruar përmes takimeve individuale me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësues të Drejtorive Komunale të Arsimit, përmes analizës së dokumentacionit ekzistues, raporteve ekzistuese që pasqyrojnë përfshirjen e nxënësve në shkollë, hulumtimeve mbi braktisjen e shkollës etj.

Sigurimi i informatave të sakta mbi shkallën e braktisjes së shkollës ka qenë i vështirë. Ministria e Arsimit, nëpërmjet zyrës për statistika, mban të dhënat statistikore të nxënësve për çdo shkollë dhe komunë, mirëpo këto të dhëna shpeshherë nuk janë të sakta meqenëse të dhënat e raporteve të fillimit të vitit shkollor nuk përputhen me të dhënat e përfundimit të tij.

Vlerësimi për gjendjen e tanishme është përmbledhur në katër pjesë:

- Politikat arsimore, planet dhe strategjitë
- Treguesit statistikor
- Hulumtimet mbi braktisjen e shkollës
- Programet mbështetëse

Politikat arsimore, planet dhe strategjitë

Përgjegjësitë në sistemin e arsimit parauniversitar janë të ndara. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë mban përgjegjësinë kryesore për politikat arsimore në vend. Deri me tani janë hartuar disa ligje dhe udhëzime administrative të cilat përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e nivelit qendror dhe lokal lidhur me planifikimin dhe koordinimin, rregullimin dhe kontrollin, personelin, financimin, transportin e nxënësve dhe mësimdhënësve dhe për funksionet tjera. Në Ligjin mbi Arsimin Fillor dhe të mesëm në Kosovë Nr. 2002/2⁵ dhe në Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.

⁵ Ligjin mbi Arsimin Fillor dhe të mesëm në Kosovë është nxjerrë në bazë të Rregullores Nr. 2002/19 të UNMIK-ut.

03/L-068⁶, nuk përkufizohet qartë termi “ braktisje “. Varësisht nga karakteristikat e zhvillimit të sistemit arsimor të një vendi, është kuptuar edhe termi “braktisje”. OECD⁷-ja, nxënësin që e le një nivel të veçantë të sistemit arsimor pa e arritur kualifikimin e parë, e përkufizon si nxënës “braktisës”. UNESCO, lënien e shkollës pa e përfunduar ciklin e filluar të një programi, e përkufizon “braktisje”. Studiuesi Morrow (1987), nxënës braktisës e quan çdo nxënës që është regjistruar paraprakisht në shkollë dhe i cili nuk është më i regjistruar në mënyrë aktive që tregohet me 15 ditë mungesë të paarsyeshme të njëpasnjëshme dhe për të cilin nuk është pranuar asnjë e dhënë formale që tregon regjistrimin në një institucion tjetër arsimor të licencuar nga shteti. Në dokumente dhe studime të ndryshme, termin “braktisje” e gjejmë me formulime të ndryshme, si: mosvijimi i mësimit, ikje nga mësimi, mosfrekuentim, etj.

Në nenin 7.15 të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm saktësohet se nëse një nxënës mungon në procesin e arsimit të detyruar, prindi (prindërit) i tij mund të detyrohet të paguajë gjoba, po qe se mungesa është rezultat i veprimeve të qëllimshme apo neglizhencës së prindit (prindërve).

Përveç ligjeve, MASHT-i ka nxjerrë Udhëzimin administrativ Nr. MASHT [I] 13/2005, në bazë të të cilit përcaktohen masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar. Edhe pse udhëzimi është nxjerrë në vitin 2005, nuk ka të dhëna që janë ndërmarrë masa ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar në shkollë, apo që kanë ndërprerë shkollimin.

Me qëllim që të sigurohet një pasqyrë reale e të dhënave të lëvizjes dhe braktisjes së nxënësve, MASHT-i ka nxjerrë Vendimin nr. 375/02-1, të datës 13.01.2006, me të cilin obligon drejtorët e shkollave në arsimin e detyruar që të evidentojnë me saktësi lëvizjen e nxënësve

⁶ Ligjin për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës është nxjerrë në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

⁷ OECD: Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

brenda vitit shkollor duke mbajtur dosjen e dokumentacionit për: rastet e transferimit të nxënësve nga një shkollë në tjetrën; informatat kthyesë për nxënësit e transferuar nga shkollat ku ata janë transferuar; braktisjen dhe shkaqet e saj. Vendimi është shpërndarë në institucionet shkollore, mirëpo treguesit e të dhënave të lëvizjes së nxënësve dhe braktisjes së shkollës tregojnë se nuk kemi një përgjegjësi të lartë të drejtorëve të shkollave karshi këtij vendimi. P.sh. sipas të dhënave statistikore për vitet shkollore 2004-2007: në nivelin fillor braktisja e shkollës nga nxënësit e regjistruar në klasë të parë, krahasuar si gjeneratë, në klasën e dytë është relativisht i lartë, 5.85%, ndërsa prej të dytës në të tretën kjo braktisje është shumë më e vogël, vetëm 0.5%⁸. Nga analiza e disa librave të klasës⁹ së parë dhe klasës së dytë, mësojmë se kjo gjendje nuk është plotësisht objektive, bëhet fjalë për menaxhim jo të mirë të të dhënave të lëvizjes së nxënësve, sidomos të atyre që janë regjistruar në klasën e parë pa e arritur moshën dhe pjekurinë për të vazhduar shkollimin¹⁰.

Në Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007/2017 është paraparë që deri në vitin 2009 të hulumtohen shkaqet e braktisjes së shkollës, ndërsa nga viti 2009-2012 të bëhet adaptimi i programeve për integrimin e nxënësve që nuk kanë qenë të regjistruar në shkollë apo që kanë braktisur shkollën¹¹. Hulumtimi për shkaqet e braktisjes është bërë në vitin 2008¹², në të janë përfshirë vetëm tetë komuna të Kosovës. Ndërsa, procesi i adaptimit të programeve për

⁸ Grup autorësh - MASHT: Treguesit dhe të dhënat statistikore në arsim 2004/05, 05/06, 06/07, Prishtinë 2008, fq.23.

⁹ Libri i klasës është dokument pedagogjik-shkollor në të cilin evidencohen të dhënat për nxënësit e klasës, orët e mësimi dhe përmbajtjet e tyre, të dhënat nga vlerësimi për çdo nxënës dhe për çdo lëndë, mungesat e nxënësve, si dhe shënime të tjera gjatë punës në klasë– përfshirë edhe të dhëna tjera statistikore.

¹⁰ Një hulumtim i veçantë për braktisjen e shkollimit nga fëmijët në klasën e parë, do të qartësonte dallimet të cilat aktualisht janë raportuar për braktisjen e shkollimit në klasën e parë kundrejt braktisjes në klasën e tretë.

¹¹ MASHT: Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007 – 2017, Prishtinë 2007, fq.75

¹² Më gjerësisht, shih raportin e grup autorëve : Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, MASHT, Prishtinë, 2008

nxënësit që e kanë braktisur shkollën ende nuk ka filluar dhe nuk ka një plan se kur do të fillohet dhe si do të harmonizohet plani i veprimit. Përveç Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007/2017, MASHT-i ka hartuar edhe Strategjinë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2007/2017. Strategjia e veçantë për integrimin e komuniteteve në arsim është bërë për shkak të pjesëmarrjes jo të kënaqshme të tyre në sistemin arsimor. Përkundër faktit se strategjia është miratuar në vitin 2007, braktisja e shkollës nga nxënësit e komuniteteve RAE është shumë e lartë, integrimi i nxënësve në shkollimin e rregullt është minimal.

Në korrik të vitit 2009 ka përfunduar hartimi i dokumentit: Plani Kombëtar i veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014. Në dokument janë përfshirë gjashtë objektiva, që duhet të arrihen deri në vitin 2014¹³.

Treguesit statistikor

Pasqyrëzat e braktisjes sipas OECD-së tregojnë se Danimarka ka shkollën më të lartë të vijueshmërisë së rregullt të nxënësve gjatë shkollimit, ndërsa shtetet si Islanda, Sllovenia dhe SHBA-të kanë probleme të mëdha të braktisjes së shkollimit nga nxënësit. Edhe Kosova është në mesin e vendeve që ka probleme të mëdha me dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Sipas të dhënave të sistemit të menaxhimit të informatave në Ministrinë e Arsimit në vitin shkollor 2008/2009¹⁴ në sistemin e arsimit parauniversitar kanë qenë të përfshirë 443.912 nxënës (Meshkuj = 235.327 & Femra= 208.585) nga parashkollorët deri në klasën e 13 të shkollës së mesme të lartë :

¹³ Plani Kombëtar i veprimit kundër braktisjes së shkollës ende nuk është miratuar.

¹⁴ Marrë nga raporti nga EMIS-it për të dhënat mbi arsimin 2008 – 2009, Prishtinë 2009.

1. Parashkollor/ mosha 3-5 vjeç = 5.091 fëmijë (Meshkuj= 2.753 & Femra= 2.338)
2. Parafillor/ mosha 5-6 vjeç = 19.674 fëmijë (Meshkuj= 10.391 & Femra= 9.283)
3. Fillor dhe i mesëm i ulët / klasa 1-9 = 322.975 nxënës (Meshkuj= 169.306 & Femra= 153.669)
4. I mesëm i lartë / klasa 10-12/13 = 96.172 nxënës (Meshkuj= 52.877 & Femra= 43.295)

Nga analiza e të dhënave statistikore nga viti shkollor 2002/2003 deri në vitin shkollor 2007/2008, mbi 22470 nxënës e kanë braktisur shkollën në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9). Kjo përqindje shënon shkallën rreth 1.50 % të nxënësve që braktisin shkollën çdo vit shkollor. Në nivelin e mesëm të lartë (klasat 10-12/13) nga viti shkollor 2002/2003 deri në vitin shkollor 2007/2008, mbi 12950 nxënës e kanë braktisur shkollimin. Treguesit statistikor tregojnë se braktisja në këtë nivel të shkollimit shënon shkallën mbi 2.40% të mesatares për çdo vit shkollor që e braktisin shkollimin në këtë nivel të arsimit. Raporti gjinor i braktisjes në këtë nivel është 2.90 % meshkuj ndërsa 1.8 % femra”¹⁵.

Hulumtimet mbi braktisjen e shkollës

Përveç treguesve dhe të dhënave statistikore në arsim, në Kosovë janë bërë hulumtime të ndryshme lidhur sistemin e arsimit në Kosovë. Në këtë raport vlejné për t’u theksuar hulumtimet për sistemin e arsimit parauniversitar të bëra nga UNICEF-i dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në mbështetje nga Ministria e Arsimit. Hulumtimet për gjendjen në arsim të realizuara nga UNICEF-i dhe që pasqyrojnë edhe të dhëna për braktisjen e shkollës janë:

¹⁵ Grup autorësh: Treguesit dhe të dhëna statistikore në arsim, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, 2008, fq. 25.

- Pasqyra gjinore në sistemin arsimor në Kosovë (2003)
- Analiza e gjendjes së arsimit në Kosovë (2004)
- Arsimi për fëmijët minoritar në Kosovë
- Regjistrimi dhe Braktisja e Shkollave nga Vajzat në Kosovë (2004) etj.

Ndërsa, hulumtimet e bëra nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) që pasqyrojnë shkurtimisht edhe të dhënat për braktisjen e shkollës janë:

- *Arsimi në Kosovë: Shifra dhe Fakte' (2000)*
- *Arsimi në Kosovë (2001)*
- Disa aspekte të efikasitetit në arsimin e Kosovës (2002)

Në vitin 2008, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë në bashkëpunim me Ekipin Koordinues të Projektit PPPA II¹⁶ dhe me financim të Bankës Botërore realizoi studimin: “Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë”. Në këtë studim janë përmbledhur të dhëna për çështjet që lidhen me braktisjen, faktorët që ndikojnë në braktisje dhe rekomandimet lidhur me parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit. Hulumtimi është shtrirë në shatë komuna të Kosovës. Është hartuar raporti i hulumtimit dhe është shpërndarë në institucione të ndryshme arsimore.

¹⁶ PPPA – Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim i financuar nga Banka Botërore. Projekti është zhvilluar në dy faza: në fazën e parë: 2003-2005 dhe në fazën e dytë 2006-2008.

Projekti është përbërë nga tre komponentë:

1. Granti për zhvillimin e shkollës – ka ofruar financim për shkolla në mënyrë që të arrihet përmirësimi i qasjes/përfshirjes së nxënësve në shkollë dhe suksesit në arsim.
2. Sistemi informative për menaxhim të arsimit – ka ofruar ndihmë në forcim dhe qëndrueshmëri të të dhënave për nxënësit dhe shkollën.
3. Menaxhimi i projekteve – ka ofruar ndihmë të drejtpërdrejtë shkollës në planifikim dhe menaxhim të projekteve.

Të gjitha shkollat e përfshira në PPPA, janë përfshirë në trajnime profesionale për planifikim dhe menaxhim të projekteve shkollore. Projekti ka paraparë që pjesëmarrja e shkollave të jetë në bashkëpunim me komunitetin. Kjo ka bërë që të gjitha shkollat konkurruese në projekte, paraprakisht të themelojnë këshillin e shkollës, të caktojnë prioritetet e projekteve të shkollës dhe të bashkëpunojnë ngushtë me prindërit dhe komunitetin në mënyrë që të sigurojnë 5 % të shumës totale të projektit nga shkolla dhe komuniteti.

Rezultatet nga hulumtimet për braktisjen e shkollës nga nxënësit në Kosovë tregojnë se në të shumtën e rasteve braktisja e shkollës është e shprehur në vendet rurale ,nga fëmijët që vijnë prej familjeve me gjendje të rëndë sociale, nga fëmijët e komuniteteve RAE. Po ashtu të dhënat tregojnë se braktisja më e madhe është evidentuar në ndërrimin e nivelit të shkollimit nga shkolla e mesme e ulët në atë të mesme të lartë, përkatësisht nga klasa e 9 në klasën e 10. Nxënësit regjistrohen, mirëpo për shkak të pozitës gjeografike – largësisë së shkollave në veçanti për nxënësit nga viset rurale dhe për shkak të kapaciteteve të vogla të infrastrukturës që kanë shkollat e mesme të larta, nxënësit nuk arrijnë të integrohen në kushtet të tilla dhe për pasojë braktisin shkollën.

Hulumtimet e bëra nga UNICEF-i¹⁷, KEC-i¹⁸ dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë në bashkëpunim me Ekipin Koordinues të Projektit PPPA II janë mjaft të rëndësishme, mirëpo nuk kanë arritur që në masë të plotë ta adresojnë problematikën e braktisjes në Kosovë. Mbetet shumë për t'u bërë në këtë fushë, në veçanti në çështjet specifike të saj, në mënyrë që të kemi rezultate të prekshme në praktikën tonë shkollore.

Projektet dhe programet mbështetëse

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, ka mbështetur projektet dhe programet mbështetëse për parandalimin e braktisjes së shkollës. Në vitin 2003, MASHT-i së bashku me CRS-në¹⁹ dhe SHPA-në²⁰ hartuan projektin për parandalimin e braktisjes. Mbi bazën e projektit u formuan dy grupe punuese: grupi për zhvillimin e mekanizmave për zvogëlimin e numrit të nxënësve që braktisin

¹⁷ Fondi Emergjent Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara

¹⁸ Qendra për Arsim e Kosovës

¹⁹ Catholic Relief Services

²⁰ Shoqatat Prindër - Arsimtarë

shkollimin, si dhe grupi që do të kujdesej në përcaktimin e roleve të Këshillit Prind – Arsimtar dhe Këshillave të shkollës . Bashkëpunimi u vazhdua edhe gjatë vitit 2004 dhe 2005. Fillimisht bashkëpunimi rezultoi me sukses në kthimin e 52 vajzave në shkollë nga komunat Prizren, Ferizaj, Lipjan dhe Malishevë dhe në realizimin e projektit: *Të gjithë në shkollë*. Pr jekti ka ndihmuar në formimin e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Mosregjistrimit dhe Braktisjes dhe në përcaktimin e qartë të detyrave të këtyre ekipeve. Në fund të projektit është hartuar *doracaku “Pako strategjishë”* - një udhëzues për trajtim të problemit të braktisjes së shkollës i cili ofron strategji afatshkurta dhe afatgjata të zgjidhjes së problemit të braktisjes. Projekti është realizuar edhe për nxënësit e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptas.

Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim, i realizuar nga Ministria e Arsimit dhe i mbështetur nga Banka Botërore është një nga projektet më të rëndësishme që është realizuar në shkollat e Republikës së Kosovës. Zhvillimi i projektit ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore për planifikim dhe zhvillim të projekteve me bazë shkolle dhe për krijimin e partneritetit bashkëpunues në shkollë. Kriteret bazë për përzgjedhjen e shkollave fituese të projektit kanë qenë: varfëria, mospërfshirja, vijueshmëria, braktisja, etj. Kjo ka bërë që shkolla, në bashkëpunim me prindërit dhe komunitetin, çështjen e braktisjes së shkollës nga nxënësit ta shqyrtojë më shumë dhe parandalimin e dukurisë së braktisjes ta vendosin si prioritet të punës së përbashkët. Qasja e tillë ka ndikuar që deri diku të zvogëlohet shkalla e braktisjes në shkollat e përfshira në projekte të PPPA.

Duke pas për bazë kompleksitetin e problematikës së braktisjes një njërën anë dhe numrin e projekteve dhe programeve mbështetëse për parandalimin e braktisjes në anën tjetër, rrjedhimisht mund të themi se pak është punuar në këtë drejtim, mbetet shumë për tu bërë, në veçanti

në adaptimin e programeve për integrimin në shkollim të rregullt të fëmijëve që më parë kanë braktisur shkollën.

Përmbledhje

Nga vlerësimi i informacionit ekzistues për braktisjen e shkollës, nga të dhënat e grumbulluara dhe nga diskutimet me zyrtarë arsimor dhe me prindër, kemi këtë përmbledhje të vlerësimit të gjendjes ekzistuese:

- Në legjislacionin aktual që rregullon sistemin e arsimit parauniversitar nuk ekziston përkufizimi i qartë për termin "braktisje". Kjo në një mënyrë ka ndikuar që të ketë dallime sa i përket të kuptuarit të braktisjes dhe trajtimit të saj.
- Në përgjithësi, institucionet arsimore janë të interesuara të merren seriozisht me problematikën e braktisjes së shkollës nga nxënësit. Mirëpo, sistemi aktual i menaxhimit të arsimit nuk përcakton qartë përgjegjësit kryesorë që duhet të merren me këtë problematikë në mënyrë të vazhdueshme, për pasojë kemi qasje të momentit të trajtimit të problematikës.
- Nuk ka strategji afatgjate për parandalimin e dukurisë së braktisjes dhe kthimin në shkollë të fëmijëve që tani më kanë braktisur shkollimin. Në fakt, është duke u hartuar Plani Kombëtar i veprimit kundër braktisjes së shkollës 2009-2014, mirëpo këtij plani i mungon një vlerësim dhe hulumtim gjithëpërfshirës i gjendjes që do të mundësonte hartimin e objektivave të qarta dhe caktimin e masave adekuate për përmirësimin e gjendjes.
- Aktualisht ekziston një sistem më i mirë i mbledhjes së të dhënave statistikore për arsim, krahasuar me të dhënat statistikore paraprake. Me gjithë këtë, ende nuk ka të dhëna statistikore të

sakta për numrin e nxënësve që kanë braktisur shkollën. Mungesa e të dhënave të sakta ka krijuar vështirësi në vlerësimin e saktë të gjendjes dhe në hartimin e projekteve të përshtatshme për luftimin dhe parandalimin e dukurisë së braktisjes dhe për mbështetjen e nxënësve braktisës.

- Hulumtimet e bëra për braktisjen e shkollës kanë bërë që institucionet arsimore të sensibilizohen më shumë për trajtimin e kësaj dukurie. Mirëpo, hulumtimet e deritanishme janë të pakta dhe jo gjithëpërfshirëse, kjo ka reflektuar në hartimin e projekteve të pjesshme për parandalimin e braktisjes.
- Sipas zyrtarëve arsimorë në Ministrinë e Arsimit, rastet e nxënësve që braktisin shkollën nuk lajmërohen me kohë. Kjo ndikon që trajtimi i rasteve që braktisin shkollën të mos jetë trajtim adekuat dhe në kohë të duhur. Shumica e zyrtarëve arsimorë në nivel qendror dhe lokal ishin të mendimit se gjatë rishqyrtimit të Ligjit për Arsim Fillor dhe të Mesëm, të pasqyrohet qartë problematika e braktisjes së shkollës, masat për parandalimin e saj.

Rezultatet dhe interpretimi i tyre

Në këtë kapitull do të pasqyrohen rezultatet e fituara nga intervistat e zhvilluara me qytetarë. Rezultatet prezantohen në mënyrë të specifikuar sipas pyetjeve të bëra të intervistuarve.

Të kuptuarit për braktisjen e shkollës

Përgjithësisht, respondentet e përfshirë në hulumtim kanë dhënë përgjigje të ndryshme për të kuptuarit e braktisjen e shkollës. Të intervistuar mbi moshën 20 vjeçare ishin në gjendje të shprehen në mënyrë më të qartë për të kuptuarit e konceptit braktisje e shkollës duke thënë se braktisje do të thotë largim nga shkolla për një kohë të gjatë ose përgjithmonë, pa përfunduar një nivel të shkollimit të nisur.

Ndërsa të rinjtë - nxënësit, braktisjen e shkollës e kuptojnë si: mosvijim i mësimit, ikje nga mësimi, mos pjesëmarrje në mësim etj. Pra, të dhënat tregojnë se të kuptuarit e braktisjes nga nxënësit bëhet ashtu si fillon braktisja e shkollës: ikje nga mësimi, mosvijimi i mësimit, mos pjesëmarrje në mësim dhe në të nxënë - braktisje e fshehtë.

Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë - gjendja aktuale

Gjendja aktuale e braktisjes së shkollës nga nxënësit në Kosovë, karakterizohet me opinione të ndryshme. Mbi 80 % e të intervistuarve shprehen se arsimi në Kosovë vazhdon të ballafaqohet me dukurinë e braktisjes së shkollës nga nxënësit. Disa nga të intervistuarit kanë dhënë edhe përshkrime të rasteve të braktisjes së shkollimit, si p.sh. : i riu N.N. nga komuna e Kaçanikut i cili kishte ardhur në Universitet për të konkurruar në Fakultetin Ekonomik, shprehet se: *kur ishim në klasën e 11, dy vajza nga fshatrat e komunës së sonë kanë ndërprerë shkollimin përgjithmonë. Nga kujdestari i klasës kemi mësuar se familjet e vajzave kanë ndikuar që aot të ndërpresin shkollën .Këto nuk janë rastet e vetme, edhe në paralelet tjera ka pasur raste të ngjashme, duke përfshirë edhe raste kur nxënësit e gjinisë mashkullore braktisin shkollën.*

Përgjithësisht ka një bindje të gjerë se në Kosovë një numër i madh i fëmijëve çdo vit ndërpresin shkollimin për arsye të ndryshme. Të intervistuarit nga komunitetet RAE shprehen se në komunitetet e tyre gjendja është me e rëndë sepse çdo ditë është në rritje numri i fëmijëve që ndërpresin shkollën, por edhe i atyre që fare nuk regjistrohen në shkollë. Gjatë realizimit të intervistave, ne – grupi hulumtues, patëm rastin të dëgjojmë një fëmijë rreth 14 vjeçar duke pyetur nënën e tij: *Nënë, sa vjet i kam unë?! Kjo për ne ishte një e dhënë mjaft e rëndësishme për pasojat që vijnë nga braktisja e shkollës.*

Niveli i arsimit ku braktisja e shkollës nga nxënësit është më e shprehur

Një masë e madhe e të intervistuarve, mbi 64% janë shprehur se në arsimin e mesëm të lartë, dukuria e braktisjes së shkollës është e shprehur në përqindje më të lartë. Ndërsa ,mbi 35 % e të intervistuarve janë shprehur se kjo ndodhë në arsimin fillor, kurse pjesa tjetër e të intervistuarve kanë dilema për nivelin e arsimit ku është e shprehur më shumë braktisja e shkollës nga nxënësit. Gjatë analizës së karakteristikave të të intervistuarve shohim se shumica e të intervistuarve që mendojnë se braktisja më e lartë e shkollës ndodh në arsimin fillor, janë pjesëtarë të komuniteteve RAE.

Shkaqet e braktisjes së shkollimit

Të intervistuarit shprehen se problemi i braktisjes së shkollës nga nxënësit është i ndikuar nga shkaqet e ndryshme. Shumica e të rinjve të intervistuar si shkak kryesor të braktisjes së shkollës nga nxënësit kanë veçuar mungesën e perspektivës e cila është duke ndikuar në rritjen e humbjes së interesimit të nxënësve për mësim. Edhe të intervistuarit tjerë, të moshave të ndryshme janë shprehur pothuajse në mënyrë të njëjtë, vetëm se këtë e kanë zbërthyer në një ndarje tjetër. Tabela në vijim pasqyron opinionet e të intervistuarve për shkaqet e braktisjes së shkollës dhe renditjes së tyre sipas ndikimit në braktisje shkollën:

Nr.	Shkaku	%
1	Gjendja e vështirë ekonomike, varfëria, papunësia	32 %
2	Humbja e interesimit për shkollim si pasojë e mungesës së perspektivës	28 %
3	Niveli jo i kënaqshëm i organizimit dhe i punës në shkolla	20%
4	Arsyet familjare si sëmundja, vdekja e prindërve , divorci i prindërve	12%
5	Mospërkrahja nga prindërit si pasojë e nivelit të ultë i arsimit të tyre	8 %

Vlen për ta veçuar mendimin e një të intervistuari lidhur me rritjen e moskujdesit të prindërve ndaj fëmijëve të tyre që është duke ndikuar edhe në rritjen e numrit të nxënësve që e braktisin shkollën: *„Prindërit janë dhënë pas punës dhe pasurisë duke harruar se pasuria më e madhe e tyre është fëmija “*

Migrimi fshat-qytet, faktor ndikues në braktisjen e shkollimit

Pas vitit 1999 në Kosovë ka pasur lëvizje të brendshme të popullsisë që nënkupton se ka pasur lëvizje të madhe edhe të nxënësve. Për këtë, nga të intervistuarit kemi kërkuar që të reflektojnë në pyetjen: Sa ka ndikuar migrimi fshat qytet në braktisjen e shkollës nga nxënësit? Mbi 65 % prej tyre janë shprehur se ky faktor ka ndikuar në masë të madhe për shkak të ndërrimit të shoqërisë dhe mos adaptimit në shoqërinë e re, mbi 25% e të intervistuarve janë përgjigjur se migrimi nuk ka ndikuar në braktisje të shkollimit sepse në shumicën e rasteve lëvizja e popullsisë është bërë për në qytet dhe kjo ka qenë përparësi për vazhdimin e shkollimit meqenëse kushtet për realizimin e procesit mësimor në shkollat e qytetit janë më të mira, pastaj kjo është varur edhe nga përkushtimi i fëmijës, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve nuk kanë dhënë opinionin e tyre, me arsyetimin se nuk kanë informata për ndikimet e lëvizjeve të brendshme në braktisjen e shkollimit.

4.1. Mangësitë e punës së shkollës që shkaktojnë braktisjen e shkollës

Të intervistuarit janë shprehur se në masë të madhe, mangësitë e punës në shkollë kanë ndikuar në braktisjen e saj nga nxënësit. Ekipi hulumtues ka kërkuar nga të intervistuarit që të specifikojnë mangësitë e punës së shkollës që ata i kanë vërejtur dhe që ato mangësi janë

reflektuar ne braktisje të shkollës nga nxënësit. Për këtë kemi marrë mendime të ndryshme, ato i kemi kategorizuar sipas përshkrimit dhe emërimit të mangësive nga të intervistuarit:

- Mosbashkëpunimi i shkollës me prindër
- Mungesa e aktiviteteve jashtëshkollore
- „Detyrimi” i bartjes së uniformës shkollore
- Ushtrimi i dhunës nga ana e mësimitdhënësve, sidomos asaj psikologjike
- Mësimdhënia si dhe planet dh e programet mësimore të mbingarkuara
- Përrjashtimi i menjëhershëm i nxënësve nga shkolla, pa ndërmarrjen e masave parajlmëruese
- Dukuritë negative në shkollë: dhuna, duhani, droga, etj dhe “presioni” i bashkëmoshatarëve për t’ju bashkëngjitur grupeve që ushtrojnë këto dukuri
- Papastërtia në shkolla
- Notat e ulëta dhe pamundësia për t’i përmirësuar ato
- Mungesa (ndërprerja) e programeve integruese
- Mungesa e mjeteve konkretizuese në mësim
- Mësimdhënësit e pa përgatitur paraprakisht për mësim

Këto kategorizime për mangësitë e punës së shkollave, janë një e dhënë se shkollat tona kanë probleme me procesin e menaxhimit, me dukuri negative, me mësimdhënie që nuk reflekton në rritjen dhe zhvillimin e interesimeve të fëmijëve për të nxënë dhe për përgatitje për jetë.

Pasojat nga braktisja e shkollimit

Të intervistuarit shprehen se pasojat nga braktisja e shkollës janë të mëdha për fëmijët që kanë braktisur shkollën, por edhe për shoqërinë. Ata numëruan një numër të madh të pasojave nga braktisja e shkollës.

Pasojat u veçuan nga shumica e të intervistuarve janë:

- Shfaqja e dukurive negative, si: përdorimi i duhanit, alkoolit, drogës dhe narkotikëve tjerë, prostitucioni, etj.
- Mbetja pa kualifikim - diplomë
- Rritja e shkallës së analfabetizmit
- Shfaqja e problemeve në familje
- Shtimi i numrit të martesave të hershme
- Mungesa e edukatës
- Humbja e kulturës për punë
- Humbja e besimit për integrim dhe ri integrim në shoqëri
- Ngadalësimi i procesi të integritimit të sistemit të arsimit kosovar në sistemet bashkëkohore të arsimit
- Rriten problemet sociale si: vjedhja, kontrabanda, krimi i organizuar, krijimi i grupeve mafioze, etj.
- Ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të vendit.

Përshkrimi dhe renditja e pasojave nga të intervistuarit tregon qartë se qytetarët gjithnjë e më shumë janë duke i ndier pasojat nga dukuria e braktisjes së shkollës. Përveç tjerash, përshkrimi i tyre është një e dhënë për drejtuesit e arsimit që të reflektojnë shpejtë në trajtimin e dukurisë së braktisjes , në të kundërtën pasojat nga braktisja e shkollës do të jenë të dëmshme për shoqërinë kosovare duke e penguar atë në integrimin e shoqërive të përparuara, integrimin në e shoqërisë së dijes.

Përgjegjësit që duhet të merren me problematikën e braktisjes së shkollës

Të intervistuarit kanë kategorizuar në tri grupe institucionet përgjegjëse që duhet të merren me çështjen e braktisjes së shkollës: *familja, shkolla, shoqëria – institucionet*. Në vend të parë kanë

radhitur institucionin familje/prindërit ,për këtë janë shprehur mbi 50% e të intervistuarve. Ata janë shprehur se familja është institucioni i parë edukativ i fëmijëve, përgjegjësia e familjes nuk përfundon me dërgimin e fëmijëve në shkollë, përkundrazi ajo në këtë fazë vetëm s'arritet. Në vendin e dytë kanë radhitur shkollën, për këtë janë shprehur mbi 35 % e të intervistuarve, kurse rreth 15 % e të intervistuarve në vendin e tretë kanë radhitur shoqërinë/institucionet tjera.

Vetë ndarja e përgjegjësve që duhet të merren me trajtimin e çështjes së braktisjes së shkollës, nënkupton se në mes tyre duhet të lidhet aleancë, bashkëpunim, partneritet cilësor në të mirë të brezit të ri në Kosovë, në të mirë të ardhmërisë së Kosovës. Është detyrë e MASHT-it dhe e institucioneve tjera që të promovojnë vlera të bashkëpunimit të qëndrueshëm në funksion të trajtimit të drejtë dhe me kohë të dukurisë së braktisjes.

Masat që duhet të ndërmerren prindërit , shkolla dhe institucionet për të parandaluar braktisjen

Ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me masat që duhet ndërmerret për të parandaluar braktisjen. Disa nga masat që janë propozuar nga të intervistuarit janë:

- Interesimi i vazhdueshëm i prindërve për vijueshmërinë e fëmijëve në shkollë dhe për rezultatet e tyre në mësim
- Kujdesi adekuat ndaj fëmijëve në mënyrë që ata të ndihen të rëndësishëm për familjen dhe shkollën
- Përfshirja e prindërve në planifikimin e projekteve shkollore
- Përshtatja e planeve dhe programeve mësimore me nivelin e nxënësve, sidomos të nxënësve të komuniteteve RAE
- Informimi i vazhdueshëm i fëmijëve për rëndësinë e shkollimit

- Paralajmërimi me kohë për masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve kanë ndërprerë shkollimin
- Plotësimi i kushteve për shkollim
- Trajtimi i rasteve individuale të fëmijëve të prirë për të braktisur shkollën, angazhimi i psikologut, pedagogut
- Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira
- Realizimi i programit për integrim me fëmijët që kanë braktisur shkollën
- Stimulimi më i madh i mësimdhënësve për punën që bëjnë
- Mbyllja e kafeve pranë shkollave
- Kontrollimi i lirive të tepruara të fëmijëve.

Të gjitha masat e specifikuar nga të intervistuarit kërkojnë trajtim të veçantë dhe mekanizma për jetësimin e tyre në praktikë. Strategjia kombëtare për trajtimin e braktisjes në mënyrë me të mirë mund t'i adresojë detajet e zbatimit të masave për parandalimin e braktisjes së shkollës.

4.2. Ofrimi i ndihmës për familjet, fëmijët e të cilave kanë karakteristika të braktisjes së shkollës

Të intervistuarit shprehen se familja është institucioni që në të shumtën e rasteve mundohet ta bëjë punën e saj në funksion të rritjes, zhvillimit dhe edukimit të fëmijës, mirëpo disa familje për shkaqe të ndryshme nuk arrijnë ta përmbushin misionin e tyre, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme. Për këtë kategori të familjeve është shumë e rëndësishme që t'u ofrohet ndihmë në formë të ndryshme, sidomos në rastet kur fëmijët kanë braktisur shkollën, apo kur tek ta shfaqen shenja për braktisjen e shkollës. Mbi 58 % e të intervistuarve shprehen se ofrimi i ndihmës familjeve për shkollimin e fëmijës është përgjegjësi e institucioneve, ndihmë e cila mund të realizohet përmes :

sigurimit të librave, fletoreve të punës, sigurimit të transportit për udhëtim shtëpi -shkollë dhe anasjelltas.

Qasje tjera në ofrimin e ndihmës për *familjet, fëmijët e të cilave kanë karakteristika të braktisjes së shkollës*, të cilat janë cituar nga të intervistuarit janë:

- Bashkëpunimi i rregullt shkollë – familje, përfshirë edhe vizitat në familje
- Informimi i vazhdueshëm institucional
- Bashkëpunimi me mjetet e informimit publik në mënyrë që ato të jenë në funksion të informimit, vetëdijesimit të shoqërisë për rëndësinë e arsimit dhe për pasojat nga braktisja e shkollimit
- Ndihmë profesionale nga pedagogët, psikologët dhe sociologët.

4.3. Masat për rikthim në shkollë të fëmijëve që paraprakisht kanë braktisur atë

Të intervistuarit shprehen se është shumë me rëndësi që të studiohen të gjitha rastet e braktisjes, sepse secili rast është histori në vete dhe mbi bazën e analizave të merren masa adekuate të cilat bëjnë që fëmijët të kthehen në shkollë dhe të integrohen në procesin mësimor. Në veçanti prindërit kanë shprehur pakënaqësinë e tyre lidhur me mungesën e programeve për integrimin e fëmijëve në shkollë që paraprakisht kanë braktisur shkollën dhe me mungesën e strategjisë dhe mekanizmave të tjerë për parandalimin e braktisjes së shkollës.

Disa nga masat e propozuara nga të intervistuarit për rikthimin e fëmijëve në shkollë, që paraprakisht kanë braktisur atë:

- Organizimi i mësimi plotësues
- Mbështetje për integrim në mësim të rregullt përmes programeve kompensuese

- Funksionalizimi i shërbimit profesional në shkollë
- Aftësimi profesional
- Hapja e perspektivës së punësimit si masë stimuluese²¹
- Ofrimi i programeve ku nxënësi do të mund të zhvillonte njohuritë dhe aftësitë e tij në praktikë

Masat për rikthim në shkollë të fëmijëve që paraprakisht kanë braktisur atë duhet të studiohen mirë, të planifikohen ,përgatiten dhe zbatohen me kujdes të veçantë në mënyrë që t'i përshtaten kontekstit dhe të reflektojnë në integrim të qëndrueshëm të fëmijëve në shkollim.

Masat ligjore ndaj prindërve të fëmijëve që braktisin shkollën

Të gjithë të intervistuarit - pa asnjë përjashtim mendojnë se duhet të merren masa ligjore ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve braktisin shkollën. Dallimet janë vetëm në llojet e masave që duhet të merren . Mbi 58 % shprehen se masat ndaj prindërve duhet të jenë me mjete financiare, mbi 25 % shprehen se duhet merren edhe masa të skajshme, si p.sh. prindërve të papërgjegjshëm tu merren fëmijët dhe shteti të kujdeset për ta, përfshirë edhe kujdesin për shkollë. Ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve shprehen se duhet të merren masa tjera administrative në mënyrë që prindërit ti kthejnë fëmijët në shkollë.

Lidhur me modelet e zbatimit të masave, të intervistuarit shprehen se duhet të analizohen modelet e vendeve të rajonit dhe me gjerë që tani e kanë zgjidhur këtë problem dhe kanë shkallë më të lartë të përfshirjes së nxënësve në shkollë. Të gjithë shprehen se zbatimi i masave ndaj prindërve duhet të rregullohet me ligj.

²¹ Ka raste kur mësimdhënësit shprehen me pesimizëm së sa i përket shkollimit , si pasojë e mungesës së perspektives, duke u referuar pagave të ulëta, trajtimit të mësimdhënësve në dekadën e fundit, stresit në punë me nxënës etj..

Ide tjera

Kishte ide tjera të ndryshme lidhur me temën e hulumtimit. Dominojnë idetë që lidhen me mjetet e informimit. Të intervistuarit shprehen se mjetet e informimit duhet të ofrojnë programe edukativo-arsimore, të prezantojnë shembuj pozitiv nga shkollat, të tregojnë përparësitë e shkollimit dhe pasojat e braktisjes së shkollës. Qytetarët thonë se mjetet e informimit duhet të jenë në funksion të edukimit të brezit të ri, në funksion të vetëdijesimit të shoqërisë për rrugën e dijes dhe për pasojat nga dukuria e braktisjes së shkollës. Të intervistuarit shprehen se emisionet me karakter edukativ dhe arsimor duhet të zënë vend më shumë në mediat tona të informimit. E gjithë kjo duhet të rregullohet në bashkëpunim me institucionet që menaxhojnë sistemin e arsimit në nivel qendror dhe në nivel lokal.

Përfundimet dhe rekomandimet

Braktisja e shkollës nga nxënësit është një çështje mjaft komplekse që kërkon hulumtim dhe studim gjithëpërfshirës. Hulumtimi kishte për qëllim që përmes një analize të gjendjes ekzistuese dhe përmes pasqyrimit të pikëpamjeve të qytetarëve të intervistuar, të sillte të dhëna për braktisjen e shkollës nga nxënësit në Kosovë. Të dhënat e hulumtimit do të ndihmojnë institucionet dhe shoqërinë në zhvillimin e bashkëpunimit më të ngushtë dhe në reagimin më të organizuar për luftimin dhe parandalimin e braktisjes së shkollës.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se sistemi ynë i arsimit vazhdon të ballafaqohet me problematikën e braktisjes së shkollës nga nxënësit. Nga të dhënat e hulumtimit shihet qartë se edhe përkundër përpjekjeve, ende nuk ka trajtim adekuat të braktisjes së shkollës nga institucionet dhe shoqëria. Kjo është duke ndodhur për shkak të mosndarjes së qartë të roleve, detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve dhe shoqërisë në parandalimin e dukurisë së braktisjes

së shkollës. Në gjendjen aktuale kërkohet një edukim i fëmijëve braktisës të shkollës, i fëmijëve të pirur për ta braktisur shkollën, por edhe i prindërve fëmijët e të cilëve kanë braktisur shkollën për të ndryshuar qëndrimet e tyre lidhur me shkollën dhe perspektiven e fëmijëve që vazhdojnë shkollimin.

Një sistem i mirë i menaxhimit të të dhënave në shkollë mund të sigurojë të dhëna ta sakta për braktisjen dhe shkaktarët e saj. Të dhënat do të mund të shërbenin si tregues të efektivitetit të ndërhyrjeve në parandalimin e braktisjes dhe do të tregonin se cilat grupe të marginalizuara kanë nevojë me të madhe për reagim të shpejtë dhe adekuat.

Kompleksiteti i çështjes së braktisjes së shkollës kërkon që të bëhen hulumtime të veçanta dhe specifike, si:

- Karakteristikat e fëmijëve që janë të prirur për të braktisur shkollën
- Karakteristikat e familjes, fëmijët e të cilave kanë braktisur shkollën
- Fëmijët nga grupet minoritare që braktisin shkollën
- Arsimiti për fëmijët që kanë braktisur shkollën
- Programet për integrimin në shkollë të fëmijëve që më herët kanë braktisur shkollën.

Në përpjekje për të qenë sa më konkret ne rekomandime, kemi bërë përpjekje që rekomandimet të drejtohen të specifikuar për Ministrinë e Arsimit dhe Drejtoritë Komunale, drejtorë të shkollave dhe mësimdhënës, prindër dhe kujdestarë të familjes.

Rekomandime për Ministrinë e Arsimit dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit:

- Përkufizimi në ligj i termit braktisje në kontekstin e sistemit të arsimit në Kosovë dhe strategjia kombëtare për luftimin dhe parandalimin e braktisjes janë çështje që duhen adresuar shpejt.

- Poashtu ,ndërtimi i sistemit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave është domosdoshmëri sepse krijon mundësi për ta ditur saktësisht shkallën e braktisjes, zonat ku është e shprehur më shumë braktisja dhe hapë rrugët e studimit të shkaqeve të saj.
- Fokusimi në çështjet përmbajtësore që drejtpërdrejtë reflektojnë angazhimin institucional në luftimin dhe parandalimin e braktisjes dhe në kthimin në shkollë të nxënësve që kanë braktisur shkollën, si:
 - adaptimi programet mësimore për nxënësit që kanë braktisur shkollën
 - përgatitja dhe implementimi në praktikë i programit për trajnimin e ekipeve komunale dhe ekipeve shkollore për parandalimin e braktisjes
 - ofrimi i grondeve stimuluese për zhvillimin e shkollave që adresojnë problemin e braktisjes
 - ndërmarrja e masave të veçanta, që kanë për synim përfshirjen e prindërve dhe komunitetit në luftimin dhe parandalimin e braktisjes së shkollës
 - sigurimi i transportit të organizuar e të qëndrueshëm për nxënësit që udhetojnë nga zonat ku braktisja është e evidente, zonat rurale dhe nga zonat ku nuk ka transport publik të qëndrueshëm
 - përfshirja e mjeteve të informimit publik në sensibilizimin e komunitetit të gjerë me shkallën e braktisjes dhe me pasojat për fëmijët braktisës të shkollës dhe për shoqërinë
 - angazhimi me përgjegjësi të lartë në ngritjen e cilësisë në arsim.

Për drejtor të shkollave dhe mësimdhënës:

- Formimi i ekipeve shkollore për trajtimin e braktisjes në shkollë duhet të jetë hapi i parë. Këto ekipe fillimisht duhet të studiojnë

braktisjen dhe shkaktarët e saj në shkollën e tyre, pastaj duhet të hartojnë planin e veprimit për luftimin dhe parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit dhe monitorimin e nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollimit.

- Bashkëpunimi me prindër dhe komunitet është detyrë tjetër e radhës. Bashkëpunimi fuqizohet duke i organizuar mirë takimet me prindër dhe komunitet, duke i përfshirë aktivisht në programin e bashkëpunimit, në projektet e përbashkëta në bazë shkolle, etj.
- Menaxhimi i informatave kthyesë për lëvizjen e nxënësve është poashtu përgjegjësi tjetër e shkollës. Në proces duhet të evidentohen nxënësit që nuk vijojnë shkollën, që nuk janë të përfshirë në procesin e të nxënësve, që kanë ndërruar shkollën, etj dhe me kohë informohen faktorët e bashkëpunimit.
- Krijimi i klimës pozitive në shkollë reflekton pozitivisht në vijueshmërinë e rregullt të nxënësve në procesit mësimor. Prandaj shkolla duhet të krijojë kushte për punë, të angazhohen me përgjegjësi të lartë në ngritjen e cilësisë së të nxënësve në shkollë, të angazhojë nxënësit në aktivitete që organizohen në klasë dhe shkollë, etj.

Për prindër dhe kujdestarë të familjes:

- Të vendosin çdo gjë për të mirën e fëmijëve të tyre, për mundësi shkollimi dhe përparimi të tyre. Kësaj duhet t'i shtohet kujdesi për komunikim të vazhdueshëm e të kujdesshëm me fëmijë, kujdesi i vazhdueshëm për vijueshmërinë e mësimi, për rezultatet në mësim dhe për integrimin e tyre në shkollë e në rrethin shoqëror.
- Të bashkëpunojnë ngushtë me shkollën dhe specialistë të arsimit. Me kohë të njoftojnë shkollën për shëndetin fizik të fëmijës, gjendjen emocionale e mendore të fëmijës, kushtet ekonomike, kushtet e banimit e të udhëtimit,

kujdesin që bëjnë ndajë fëmijës, për rastet kur fëmija nuk mund të shkojë në shkollë dhe për shkaqet e mos shkuarjes etj. Të pranojë rolin dhe përgjegjësitë ndaj fëmijës dhe shkollës.

Referencat

1. Grup autorësh (2004): Analiza e gjendjes së arsimit në Kosovë, UNICEF, Prishtinë.
2. Grup autorësh (2001): Arsimi në Kosovë 2000/2001, KEC, Prishtinë.
3. Grup autorësh (2008): Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë, MASHT, Prishtinë.
4. Grup autorësh (2002): Disa aspekte të efikasitetit në Arsimin e Kosovës, KEC, Prishtinë.
5. Grup autorësh (2005): Doracak – pako strategjish, Të gjithë në shkollë...Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkollë, CRS, Prishtinë,.
6. Grup autorësh (2005): Hulumtim mbi dhunën ndaj fëmijëve në shkollat e Kosovës, UNICEF, Prishtinë.
7. Grup autorësh (2003): Pasqyra gjinore në sistemin arsimor në Kosovë, UNICEF, Prishtinë.
8. MASHT(2004): Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë. Prishtinë.
9. MASHT(2008): Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës. Prishtinë.
10. MASHT & UNICEF (2004): Regjistrimi dhe braktisja e vajzave në Kosovë, Prishtinë.
11. MASHT (2007): Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007-2017, Prishtinë.

12. MASHT (2008): Treguesit dhe të dhëna statistikore në arsim. 2004/05, 05/06, 06/07. Prishtinë.
13. MASHT (2005): Udhëzimin administrativ Nr. MASHT [I] 13/2005: Masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar, Prishtinë.